



Data: 11.08.2017

Ref.: 681117

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Pezullohet akreditimi i programit të studimit të BPrAL Kolegji “AAB” për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018 në kampusin në Prishtinë:
 - Dizajn Enterier, BA, 180 ECTS (vendimi nr.651/16, datë 15.07.2016).
- II. Ndalohet regjistrimi i studentëve në vitin akademik 2017/2018 në programin e studimit të cekura në pikën I (një) të këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Bazuar në kërkesën e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) drejtuar të gjitha Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) për dorëzimin e listave të stafit akademik për të gjitha programet ekzistuese, dhe pas verifikimit nga AKA te dokumentacionit te dorëzuar nga BPrAL Kolegji “AAB”, u konstatua se programi i cekura në pikat I (një) të këtij vendimi nuk i plotëson kriteret sipas nenit 11, pika 3.2. e Udhëzimit Administrativ (nr.20/2016, datë 20.09.2016) mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës. Sipas UA për Akreditim nenit 11, pika 3.2, për secilin program të studimit duhet të kenë të paktën tri staf akademik me marrëdhënie të rregullt të punës me gradën shkencore Dr.sc. apo ekuivalentë me te.

Bazuar ne kriteret të cilat i parashihen në UA për Akreditim, nenit 11, pika 3.2, janë trajtuar të gjitha dokumentet të cilat janë dorëzuar nga Kolegji "AAB", dhe si përfundim është konstatuar që programi e cekura në pikat I (një) të këtij vendimi nuk i ka tre bartës të programit me dokumentacion te rregullt sipas UA për Akreditim neni 11, pika 3.2.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2017 ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e dorëzuara nga BPrAL Kolegji "AAB", dhe ka konstatuar që programi i cekura në pikën I, të këtij vendimi nuk i përmbushin kriteret e cekura në UA për Akreditim, dhe në këtë rast KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në UA për Akreditim, neni 28 , pika 2 dhe 3, AKA mund ta tërheq akreditimin ne rastet e caktuara. Sipas këtij neni, AKA mund ta tërheq akreditimin në rast se ka dëshmi se cilësia e ofrimit të programeve të studimit në një ose më shumë fusha për të cilat është dhënë akreditimi është dëmtuar në masë të madhe në këtë rast KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet në Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Kjo këshill juridike jepet duke u bazuar nenin 157 (Dispozitat kalimtare) të Ligjin për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr.05/L-031, datë 25 maj 2016) i cili ka hyrë në fuqi me 21 qershor 2017. Sipas këtij neni Procedurat administrative të filluara dhe të pa përfunduara në datën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, do të vazhdojnë sipas dispozitave të mëparshme ligjore, që kanë rregulluar procedurën administrative. Ligji, do të vazhdojnë sipas dispozitave të mëparshme ligjore, që kanë rregulluar procedurën administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "AAB";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

